

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të  
Auditimit të Brendshëm  
Internal Audit Knowledge  
Elements**

**B1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 04.10.2025

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- Roli dhe fokusi i funksionit të auditimit të brendshëm në menaxhimin e rrezikut të ndërmarrjes (ERM) me synimin për të përmirësuar qeverisjen e korporatave përfshin cilën nga të mëposhtmet?
  - Ndjekja (follow-up) e kartave të vlerësimit të ERM.
  - Kontrollet e brendshme për ERM.
  - Standardet e IIA për ERM.
  - Ndjekja (follow-up) e matjeve të ERM.
  - I dhe II
  - II dhe III
  - I dhe IV**
  - III dhe IV
- Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet procesin e plotë të menaxhimit të rrezikut?
  - Menaxhimi i rrezikut = Zvogëlimi i rrezikut + Monitorimi i rrezikut
  - Menaxhimi i rrezikut = Vlerësimi i rrezikut + Zvogëlimi i rrezikut
  - Menaxhimi i rrezikut = Vlerësimi i rrezikut + Zvogëlimi i rrezikut + Monitorimi i rrezikut**
  - Menaxhimi i rrezikut = Vlerësimi i rrezikut + Monitorimi i rrezikut
- Mos zbatimi siç duhet dhe në kohën e duhur të planit strategjik të biznesit dhe kur qëllimet e menaxherëve dhe qëllimet e personelit jo menaxhues janë jo në përputhshmëri me qëllimet e organizatës paraqet shembull të:
  - Rrezikut strategjik dhe i biznesit**
  - Rrezikut organizativ
  - Rrezikut të shkaktuar nga menaxhmenti
  - Rrezikut të kapitalit njerëzor
- Cili opsion i zbutjes së rrezikut është më i përshtatshëm kur rreziku ka frekuencë të ulët, por ashpërsi të lartë?
  - Shmangia e rrezikut
  - Reduktimi i rrezikut
  - Transferimi i rrezikut**
  - Pranimi i rrezikut
- Cila formulë e mëposhtme e përkufizon saktë rrezikun e mbetur?
  - Rreziku i mbetur = Rreziku i përgjithshëm + Masat e kontrollit
  - Rreziku i mbetur = Rreziku i mundshëm - Rreziku i mbuluar**
  - Rreziku i mbetur = Masat e kontrollit - Rreziku i mundshëm
  - Rreziku i mbetur = Rreziku i përgjithshëm + Zvogëlimi i rrezikut

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

6. Cila nga sa vijon është një përgjegjësi kyçe e Komitetit të Auditimit?
  - a) Hartimi i strategjisë së biznesit
  - b) Ratifikimi i zgjedhjes së auditorit të jashtëm**
  - c) Menaxhimi i qendrës së të dhënave financiare
  - d) Caktimi i pagave të menaxhmentit të lartë
  
7. Në procesin e komunikimit, gatishmëria e marrësit për të pranuar mesazhin është parakusht kryesor për:
  - a) Kodim të suksesshëm
  - b) Dekodim të suksesshëm**
  - c) Zhurmë
  - d) Zgjedhjen e mediumit
  
8. Cila nga të dhënat e mëposhtme NUK kërkohet për llogaritjen e SPE/EOQ?
  - a) Kërkesa vjetore në njësi
  - b) Kostoja fikse e bërjes së një porosie
  - c) Kostoja vjetore e mbajtjes së një njësie në stok
  - d) Koha e dërgimit/dorëzimit dhe vonesat në transport**
  
9. Cili përshkrim identifikon më mirë një Marrëveshje për Nivelin e Shërbimit (SLA)?
  - a) Dokument që liston kërkesat teknike për ofertuesit (RFP)
  - b) Marrëveshje që përcakton nivelin e pritshëm të shërbimit dhe kompensimin në rast të dështimit**
  - c) Plan operativ i brendshëm për burimet njerëzore
  - d) Politikë e privatësisë së brendshme për punonjësit.
  
11. Cila strukturë organizative përshkruhet si “hibrid” që kombinon strukturat funksionale dhe divizionale njëkohësisht?
  - a) Funksionale
  - b) Matricë**
  - c) Rrjet
  - d) Shumëdivizional
  
12. Analiza e cila aplikohet për investime dhe tregon se sa do të ndryshojë kthimi në një investim ose vlera e tanishme neto si përgjigje në një ndryshim të caktuar në një variabël të dhënë të pavarur, kur të gjithë faktorët tjerë mbahen konstant paraqet:
  - a) Analizën e ndjeshmërisë**
  - b) Analizën e opsionit
  - c) Analizën kosto përfitim
  - d) Analizën e vlerës së prishtshme

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

13. Cila nga opsionet e më poshtme NUK është lloj i praktikës së mirë për të reduktuar rreziqet e prodhimit dhe procesit?
- a) Caktimi i zyrtarit kryesor të prodhimit.
  - b) Projektimi për sigurinë .
  - c) Dizajnimi për mjedis të gjelbër.
  - d) Kryerja e studimeve për vendosjen e standardeve.**
14. Rreziku i kontratës është rezultatet i mos veprimit në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës, duke çuar në dështimin të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, gjobave dhe dërgesave të vonuara, si dhe shpien në rreziqe financiare dhe ligjore. Cila nga opsionet e mëposhtme është praktikë e mirë për të reduktuar rreziqet e kontratës?
- a) Monitorimi i performancës së kontraktorit.**
  - b) Kuptimi i mjedisve globale ekonomike, politike, dhe kulturore.
  - c) Përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare të tregtimit si me vendet importuese ashtu edhe me vendet eksportuese.
  - d) Motivimi dhe edukimi i punonjësve për të zvogëluar tundimit për të përjetësuar mashtrimet dhe për të kultivuar një kulturë të kontrolleve.
15. Nëse një mbikëqyrës përdor një qasje të mbështetëse të menaxhimit, e cila dëshmohet nga ndjenja pozitive dhe shqetësim për vartësit, mund të rezultojë në problem sepse:
- a) Një qasje e bazuar në fuqi të pastër e bën të vështirë motivimin e stafit.
  - b) Kjo qasje varet nga shpërblimet materiale për punëtorin.
  - c) Kjo qasje varet nga njerëzit që duan të punojnë, të rriten dhe të arrijnë.**
  - d) Menaxheri duhet të besojë në qasjen e punës në ekip.
16. Struktura e një organizate zakonisht ndjek strategjinë e saj të përgjithshme. Në njërin anë janë organizatat organike të strukturuar lirshëm, ndërsa në anën tjetër janë organizatat mekanike shumë të centralizuara, dhe me kontrolle të forta.
- Një kompani është pioniere në ndërthurjen e teknologjive lazer dhe teknologjisë robotike. Shkencëtarët dhe inxhinierët e kompanisë mbajnë shumë patenta. Ata vazhdimisht kërkojnë mënyra për të përmirësuar produktet e tyre si dhe për të prezantuar produkte të reja. Identifikoni opsionin më të përshtatshëm strukturor për këtë organizatë:
- a) Mekanik.
  - b) Imitues.
  - c) Organike.**
  - d) Holistik.
17. Cili nga opsionet e mëposhtme është mediumi më i pasur për komunikim?
- a) Biseda telefonike.
  - b) Diskutim ballë për ballë.**
  - c) Media elektronike.
  - d) Media e shkruar.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Grumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

18. Cila nga të mëposhtmet është sekuenca e saktë e qëllimeve organizative nga pikëpamja nga poshtë-lart?
- a) Qëllimet operacionale, strategjike, taktike.
  - b) Qëllimet taktike, operacionale, strategjike.
  - c) Qëllimet strategjike, taktike, operacionale.
  - d) Qëllimet operacionale, taktike, strategjike.**
19. Cila nga strategjitë e mëposhtme mund të jetë fitimprurëse për një organizatë kur klientët janë besnikë dhe të gatshëm të paguajnë çmime të larta për produktet ose shërbimet e saj?
- a) Fokusimi
  - b) Rritja e brendshme
  - c) Udhëheqja e kostos
  - d) Diferencimi**
20. Formulimi i strategjisë përfshin cilën nga të mëposhtmet?
- a) Formulimi i strategjisë në nivel të korporatave, nivel të biznesit dhe nivel të divizioneve.
  - b) Formulimi i strategjisë në nivel funksional, në nivel të punonjësve dhe në nivel të klientit.
  - c) Formulimi i strategjisë në nivelit të korporatës, nivel të biznesit dhe nivel funksional.**
  - d) Formulimi i strategjisë në nivelin bazë, nivel të zyrës dhe nivel të magazinës.
21. Në kontekstin e menaxhimit total të cilësisë, mënyra më e mirë për të identifikuar dhe eliminuar hapat e panevojshëm të punës në një proces kryhet përmes:
- a) Diagramit të rrjedhjes**
  - b) Diagramit tabelor
  - c) Diagramit me vija.
  - d) Tabela Pareto.
22. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet aktivitetin mbështetëse të zinxhirit të vlerës?
- a) Logjistika.
  - b) Prokurimi.**
  - c) Operacionet.
  - d) Shërbimi
23. Cila nga mjetet e mëposhtme të përmirësimit të procesit të menaxhimit të cilësisë totale monitoron matjet aktuale kundrejt matjeve të dëshiruara të cilësisë gjatë operacioneve të përsëritura?
- a) Grafiku i rrjedhjes
  - b) Histogrami
  - c) Diagrami shpërndarës.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

Nga 2 pikë secila

**d) Grafiku i kontrollit**

24. Në analizën e regresionit, cili nga koeficientët e mëposhtëm të korrelacionit përfaqëson marrëdhëniet më të fuqishme midis variablave të pavarur dhe të varur?
- a) 1.03.
  - b) - 0,02.
  - c) - 0,89.**
  - d) 0,75.
25. Një kompani ka një kompjuter që nuk i nevojitet më për shkak të një operacioni të ndërprerë. Aktualisht ka disa projekte kompjuterike që mund të jenë në gjendje të përdorin makinerinë, por disa modifikime do të jenë të nevojshme nëse një aplikacion i tillë i ri do të jetë i suksesshëm. Identifikoni teknikën më të përshtatshme për këtë situatë.
- a) Listimi i attributeve.**
  - b) Hulumtimi i operacioneve.
  - c) Analiza e matricës morfologjike.
  - d) Sinektikat.
26. Gjatë tre fazave të fundit të procesit të zhvillimit të grupit, konflikti tenton të ketë lidhje me cilën nga opsionet e mëposhtme?
- a) Marrëdhëniet ndërpersonale.**
  - b) Fuqinë dhe autoritetin.
  - c) Çështjet e aksioneve dhe bonuseve.
  - d) Titullin e punës dhe përfitimet.
27. Efekti negativ i cituar më së shpeshti i politikës në zyrë është:
- a) Shpërqendrimi i menaxherëve nga qëllimet organizative.**
  - b) Keqpërdorimi i burimeve nga punonjësit.
  - c) Tërheqja e vëmendjes duke japur ide.
  - d) Krijimi i konfliktit midis punonjësve.
28. Individët e përfshirë në një cikël konfliktesh konkurruese kanë cilin qëndrim të mëposhtëm?
- a) Qëndrimin Humbës - humbës
  - b) Qëndrimin Fitues - humbës**
  - c) Qëndrim fitues - fitues.
  - d) Qëndrimin fitues me të gjitha kostot.
29. Cila nga teknikat e mëposhtme të zgjidhjes së konfliktit largon burimet aktuale të konfliktit?
- I. Zgjidhja e problemeve
  - II. Detyrimi
  - III. Kompromisi
  - IV. Zbutja

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- a) Vetëm I.
- b) Vetëm II.
- c) I dhe III.**
- d) II dhe IV.

30. Cili nga opsionet e mëposhtë është hapi i parë në procesin e negociimit me vlerë të shtuar (AVN)?

- a) Qartësimi i interesave.**
- b) Identifikimi i zgjedhjeve.
- c) Përzgjedhja e një marrëveshjeje.
- d) Përsosja e marrëveshjes.

31. Cila nga strategjitë e mëposhtme duhet të përdoret nga menaxhmenti për tejkalimin e rezistencës ndaj ndryshimit të shkaktuar nga punonjësit, kur një ndryshim i shpejtë është i nevojshëm?

- a) Manipulimi dhe përvetësimi
- b) Detyrimi i qartë dhe i nënkuptuar**
- c) Lehtësimi dhe mbështetja
- d) Negocimi dhe marrëveshja

32. 'Phishing' ose 'pharming' është një kërcënim për shenjat (token) e përdorura për vërtetimin elektronik. Cila nga opsionet e mëposhtmet është një kundërmasë për të zbutur kërcënimin e 'phishing' ose 'pharming'?

- a) Përdorimi i shenjave që gjenerojnë vërtetues të lartë entropie.
- b) Përdorimi i shenjave kriptografike harduerike.
- c) Përdorimi i shenjave me vërtetues dinamikë.**
- d) Përdorimi i shenjave shumë faktorësh.

33. Nga pikëpamja e efektivitetit të kontrollit të hyrjes, cila nga opsionet e mëposhtme paraqet identifikimin biometrik kur një përdorues paraqet së pari një kombinim të një mostre biometrike dhe më pas një numër personal identifikimi (PIN) për vërtetim?

- a) Përputhja një-me-një
- b) Përputhja një-me-shumë**
- c) Përputhja shumë-me-një
- d) Përputhja shumë-me-shumë

34. Një shofer kamioni, i cili është punonjës i një kontraktori të pajisjeve mbrojtëse, transporton pjesë dhe komponentë shumë të ndjeshëm nga fabrika e prodhimit të kontraktorit të pajisjeve mbrojtëse në një instalim ushtarak në një vend shumë të sigurt. Departamenti i pritjes i ushtrisë gjurmon vendndodhjen fizike të shoferit për të siguruar që nuk ka probleme sigurie gjatë rrugës për në instalim. Me të mbërritur në instalim, shoferi i kamionit tregon distinktivin e punonjësit të tij me ID fotografike të lëshuar nga kontraktori i pajisjeve mbrojtëse, fut fjalëkalimin dhe PIN-in e tij dhe merr një mostër biometrike të shenjave të gishtit para se të futet në instalim dhe të shkarkojë përmbajtjen e kamionit. Çfarë përfaqëson ky skenar i përshkruar?

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

- a) Vërtetimin me një faktor.
- b) Vërtetimin me dy faktor.
- c) Vërtetimin me tre faktor.
- d) Vërtetimin me katër faktor.**

35. Cila nga opsionet e mëposhtme NUK është një masë parandaluese kundër sulmeve të ndërhyrjes në rrjet?

- a) Firewalls.
- b) Auditimi.**
- c) Konfigurimi i sistemit.
- d) Sistemi i zbulimit të ndërhyrjeve.

36. Më 1 janar, një kompani krijon një llogari të parave të imta dhe caktoi një punonjës si kujdestar të parave të imëta. Shuma origjinale e përfshirë në fondin e parave të imëta është 500€ dhe do të përdoret për të bërë pagesa të vogla parash. Fondi do të rimbushet në datën e parë të çdo muaji, pasi kujdestari i parave të imta të paraqesë faturat për pagesa të arkëtari i përgjithshëm.

Pagesat e mëposhtme janë bërë në muajin janar:

Furnizim për zyre 173€

Posta 112€

Argëtim 42€

Bilanci në llogarinë e parave të imta në fund të janarit është 163€. Regjistrimi kontabël i kërkuar në fund të janarit është:

- a) Furnizim për zyre 173€ - Posta 112€ - Argëtim 42€ - Paraja 327€
- b) Furnizim për zyre 173€ - Posta 112€ - Argëtim 42€ - Paraja e imët 327€
- c) Furnizim për zyre 173€ - Posta 112€ - Argëtim 42€ - Paraja 337€ - Mungesa/Teprica e parasë 10€**
- d) Furnizim për zyre 173€ - Posta 112€ - Argëtim 42€ - Paraja 317€ - Mungesa/Teprica e parasë 10€

Çdo artikull i shpenzimeve njihet, paraja kreditohet për shpenzimet totale plus mungesën e parave ( $173€ + 112€ + 42€ + 10€ = 337€$ ) dhe mospërputhja debitohet në llogarinë "mungesa/teprica e parave". Mospërputhja është bilanci fillestar i fondit minus shpenzimet totale të dokumentuara minus gjendjen përfundimtare e fondit:  $500€ - 327€ - 163€ = 10€$ . Fondi i parave të imëta është i shkurtër për 10€ kështu që llogaria e mungesave/tepricave të parave të gatshme debitohet nga kjo shumë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

37. Nga auditimi i një kompanie janë zbuluar katër gabime si më poshtë që kanë ndodhur por nuk janë korrigjuar:

Inventari më 31 Dhjetor 2019 – 40,000€, i nënvlerësuar.

Inventari më 31 dhjetor 2020 - 15,000€, i mbivlerësuar.

Amortizimi për vitin 2019 – 7,000€, i nënvlerësuar.

Shpenzimet e përlllogaritura më 31 dhjetor 2020 - 10,000€, të nënvlerësuara.

Gabimet ndikojnë që fitimet e mbajtura të raportuara më 31 dhjetor 2020 të:

a) Mbivlerësohen për 65,000€.

**b) Mbivlerësohen për 32,000€.**

c) Mbivlerësohen për 25,000€.

d) Nēnvlerësuar për 18,000€.

38. Pasuritë/asetet e një kompanie që është në proces të likuidimit duhet të regjistrohen në pasqyrën e pozitës financiare në:

a) Koston historike të pa amortizuar.

b) Vlerën e drejtë të tregut.

**c) Vlerën neto të realizueshme.**

d) Koston aktuale.

39. Një kompani shet një pjesë të makinerive, për para të gatshme, para përfundimit të jetës së dobishme të vlerësuar. Çmimi i shitjes është më i vogël se vlera neto në libra e pasurisë në datën e shitjes. Regjistrimi kontabël që kompania duhet ta bëjë për shitjen është:

**a) Debi: Paraja në dorë**

**Debi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria**

**Debi: Humbja nga shitja e makinerisë**

**Kredi: Makineria**

b) Debi: Paraja në dorë

Debi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria

Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë

Kredi: Makineria

c) Debi: Paraja në dorë

Debi: Humbja nga shitja e makinerisë

Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria

Kredi: Makineria

d) Debi: Paraja në dorë

Debi: Makineria

Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria

Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

40. Një kompani përdor metodën e amortizimit të shumës së shifrave për vite. Cila pjesë e kostos së amortizueshme të një pasurie katër vjeçar do të shpenzohet në vitin e tretë të përdorimit të aktivitetit?

- a) 10%
- b) 20%**
- c) 30%
- d) 33,33%

Nën metodën e shumës së shifrave të viteve, pjesa e kostos së amortizueshme që llogaritet si shpenzim në çdo vit të caktuar llogaritet si: numri i viteve të vlerësuara të jetës së mbetur në fillim të vitit pjesëtuar me shumën e viteve të jetës së dobishme të vlerësuar. Prandaj, pjesa në shpenzim në vitin e tretë të një aktivi me një jetë të dobishme të vlerësuar katër vjeçare =  $2 / (1 + 2 + 3 + 4) = 2/10 = 20\%$ .

41. Një kompani kishte 260,000€ fitim neto për 2020. Të dhënat e mëposhtme janë në dispozicion nga raporti i fundit vjetor:

|                      | Më 31.12.2020 | Më 31.12.2019 |
|----------------------|---------------|---------------|
| Pasuritë afatshkurta | 220,000       | 200,000       |
| Toka dhe makineritë  | 1,780,000     | 1,700,000     |
| Gjithsej pasuritë    | 2,000,000     | 1,900,000     |
| Gjithsej detyrimet   | 700,000       | 600,000       |

Norma mesatare e interesit në detyrimet totale të kompanisë është 10%. Cili është kthimi i kapitalit të kompanisë (ROE)?

- a) 20.0%.**
- b) 13.0%.
- c) 37.1%.
- d) 16.5%.

Kapitali aksionar sipas pasqyrës së pozitës financiare është: Gjithsej pasuritë - Gjithsej detyrime = 2,000,000€ - 700,000€ = 1,300,000€. Formula për ROE = Fitimi neto / Kapitali aksionar = 260,000€ / 1,300,000€ = 20%.

42. Një park i lojërave për fëmijë bleu një makinë rrotulluese të re për park dhe e financoi atë përmes prodhuesit. Më poshtë janë dhënë informata lidhur me blerjen:

Çmimi i blerjes 800,000€  
Kosto e dorëzimit 50,000€  
Kosto e instalimit 70,000 €  
Kosto e provave teknike 40,000€  
Tarifat e interesit për vitin e parë 60,000€

Kompania përdor metodën e vijës së drejtë të zhvlerësimit. Llogaritni zhvlerësimin e makinës për vitin e parë duke supozuar një jetëgjatësi të vlerësuar prej pesë vjetësh.

- a) 160,000€
- b) 184,000€
- c) 192,000€**
- d) 204,000€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

Vlera e pasurisë në libra = Çmimi i blerjes 800,000€ + Kosto e dorëzimit 50,000€ + Kosto e instalimit 70,000€ + Kosto e provave teknike 40,000€ = 960,000€ ; Zhvlerësimi 960,000 / 5 vite = 192,000€

43. Një kompani jep me lizing një ndërtesë të re. Titulli i ndërtesës do t'i kalojë lizingmarrësit në fund të qirasë. Bazuar në këto fakte, për lizing marrësin:
- a) **Do të jetë një lizing kapital, pavarësisht nga fakte shtesë.**
  - b) Do të jetë një lizing kapital, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera të nevojshme.
  - c) Do të jetë një lizing operative, pavarësisht nga ndonjë fakt shtesë.
  - d) Do të jetë një lizing operative, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera të nevojshme.
44. Cila nga opsionet e mëposhtme i referohet shkallës në të cilën njerëzit pranojnë pabarazinë midis institucioneve, organizatave dhe njerëzve?
- a) **Distanca e fuqisë.**
  - b) Shmangia e pasigurisë.
  - c) Individualizmi.
  - d) Kolektivizmi.
45. Cila nga opsionet e mëposhtme është faza e fundit e procesit të ndërkombëtarizimit?
- a) Eksportimi
  - b) Licencimi.
  - c) **Investimet e huaja direkte.**
  - d) Ndërmarrjeve të përbashkëta.
46. Cila nga opsionet e mëposhtme është një strategji globale që mund të përdoret për të përmirësuar pozicionin konkurrues të një kompanie karshi diferencimit?
- a) **Shpërndarja e brendshme e produkteve elitare të blera nga prodhuesit e huaj.**
  - b) Përdorimi i shërbimit të montimit nga shtetet e huaja me kosto të ulët në prodhimin e mallrave.
  - c) Blerja e komponentëve ose lëndëve të para të huaja me kosto të ulët.
  - d) Markimi i produkteve të gatshme që janë nënkontraktuar për prodhuesit e huaj me kosto të ulët.
47. Sa i përket etikës në biznes, mosrespektimi i ligjeve, rregullave dhe rregulloreve përfaqëson cilën nga mosrespektimet e mëposhtmet?
- I. Ligjor dhe etik.
  - II. Ligjor dhe jo etike.
  - III. I paligjshme dhe etike.
  - IV. I paligjshëm dhe jo etik.
- a) Vetëm I
  - b) Vetëm II
  - c) Vetëm III
  - d) **III dhe IV**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

**Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!**

**Nga 2 pikë secila**

48. Cili nga elementët e gjykimit moral i referohet aftësisë për të perceptuar që një rrjet i marrëdhënieve ekonomike konkurruese është, në të njëjtën kohë, një rrjet i marrëdhënieve morale ose etike?
- a) **Imagjinata morale.**
  - b) Identifikimi dhe urdhërimi moral.
  - c) Vlerësimi moral.
  - d) Toleranca ndaj mosmarrëveshjes dhe paqartësisë morale.
49. Lidhur me etikën ndërkombëtare të biznesit, cila nga opsionet e më poshtë do të ilustronte më së mirë një rast të dhënies së parave palës tjetër për qëllimin kryesor që ta bëjë palën tjetër të bëjnë diçka që ata supozohet të bëjnë gjithsesi?
- a) Një agjenci reklamash i jep para një prodhuesi makinash në mënyrë që kjo e fundit të bëjë reklamat tek kjo kompani.
  - b) Një kompani kimike i jep para një blerësi të mundshëm për ta bindur këtë të fundit për të blerë kimikatet e kësaj kompanie.
  - c) **Menaxheri përgjegjës për dërgimet emergjente të pajisjeve mjekësore i jep para një zyrtari të portit për të shpejtuar shkarkimin dhe shpërndarjen e furnizimeve.**
  - d) Kompania A i jep para Kompanisë B si një "bonus" nëse kjo e fundit nënshkruan një kontratë me të parën.
50. Lidhur me sigurinë e teknologjisë së informacionit, koncepti i personit të matur ka të bëjë me cilën prej opsioneve të më poshtme?
- a) Kujdesin e duhur dhe lejet e duhura.
  - b) Kujdesin e duhur dhe të drejtat e duhura.
  - c) **Kujdesin e duhur dhe dilijent**
  - d) Kujdesin e duhur dhe privilegjet e duhura.